

STATUT

I

SHOQËRISE TREGËTARE “OLYMPIA LABORATOR” sh.p.k.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Sipas kërkesave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, sot me date 25.05.2021 krijohet shoqëria tregtare **“OLYMPIA- LABORATOR” sh.p.k.** e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, nenet e këtij statuti si dhe aktit bashkëngjitur tij.

KREU II

EMRI, STATUTI, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar **“OLYMPIA- LABORATOR” sh.p.k.** me themelues:

- 1- Z. Avni Haruni i biri i Dashnor, e datelindjes 31.12.1991, lindur ne Gramsh me nr.personal leternjoftimi J11231050B dhe banues ne Tirane;**

NENI 3

Shoqëria do të ketë statusin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.

NENI 4

Selia e shoqërisë tregtare private **“OLYMPIA-LABORATOR” sh.p.k.**, do të jetë në adresën Rr. Iljaz Reka, Lagjia Nr 4 ,Nderesa nr 9, Kati 1, Durrës; Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat mbi 10 vjet.

NENI 6

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje **“OLYMPIA- LABORATOR” sh.p.k.**, niptin e shoqërisë, Durrës Albania

KREU III

OBJEKTI

NENI 7

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Laborator mjekesor

KAPITALI

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe zotërohet si më poshtë:

- **Avni Haruni** zotëron 100% te kapitalit **ne vlerë 100.000 lekë e ndarë në 1 kuotë**

NENI 9

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 10

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakut brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

NENI 11

Kapitali shoqërisë do të përbëhet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luejtëshme e të paluejtëshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 12

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet e lindura më parë ndaj shoqërisë. Gjithashtu ai gëzon të gjitha të drejtat e lindura para largimit të tij.

KREU IV

ORGANET DREJTUESE

NENI 13

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- **Asambleja e Ortakëve;**
- **Administratori;**
- **Administratori i Shoqërisë do të jetë Zj. Eva Haruni me afat 5-vjet me të drejtë ripërsëritje;**

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë:

NENI 14

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimor.

NENI 15

Asambleja e ortakëve vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, shtimin ose pakësimin e kapitalit, për emërimin e organit administrativ, për drejtimet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 16

Administrator i shoqërisë **“OLYMPIA- LABORATOR” sh.p.k** është **Zj. Eva Haruni** e bija e Dashnor , e datëlindjes 16.10.1987, lindur në Gramsh dhe banues në Tiranë.

NENI 17

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 6 të këtij statuti.

Organi Administrativ është kompetent për:

- të realizuar mbledhjen e Asamblesë së ortakëve;
- të miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozon rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit, etj. ;
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- përfaqësuar shoqërinë në regjistrin e pronës sipas nenit 20 të këtij statuti.

KREU V

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 18

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si cdo person tjetër juridik në Shqipëri, mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

NENI 19

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e rregjistrimit në organet tatimore, ndërsa vitet e tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti;
Në çdo fund të periudhës ushtrimore hartohet bilanci kontabël sipas ligjeve në fuqi brenda dates 31 Mars të vitit pasardhës nxirret bilanci;
Bilancet periodike (mujore, tremujore dhe gjashtëmujore) miratohen e nënshkruhen nga Administratori e më pas në mbedhjen e radhës së Asamblesë së Ortakëve;
Bilancet vjetore miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe nënshkruhen nga administratori.

NENI 21

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria u mbetet në përdorim Ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likujduar të gjitha detyrimet dhe të jete hequr fondi i rezervës ligjore, sipas vendimit të Ortakëve.

NENI 22

Marëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në R.Sh. Mosmarveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë sic është parashikuar në kontratë.

KREU VI

NENI 23

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Ortakëve për shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative;
- pamundësi veprimi;
- shpërndahet me vullnetin e ortakëve;
- riorganizohet në një formë tjetër;

NENI 24

Në kushtet e nenit 23 të këtij statuti Asambleja e Ortakëve cakton një ose më shumë likujdatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer gjithë veprimet e likuidimit të saj, duke likujduar në radhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likuidimit, kjo i shpërndahet ortakëve, ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit ortakët janë të detyruar të derdhin kuotën deri në nivelin e kuotave të kapitalit themeltar.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 25

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

NENI 26

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve që do të bëjnë ortakët si dhe ligjeve të vecanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxiret vetë statuti.

NENI 27

Ky statut u përpilua në prani të Ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të lirë.

Ai u përpilua në tre kopje me fuqi të barabartë secila për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë, në zyrën e Tatim -Taksave dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU VETEM

AVNI HARUNI

